

Vendim nr. 77 datë 11.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 11.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SULEJMAN BARDHI, përfaqësuar nga avokat Armando Syri, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4443, datë 07.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pika 1, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Sulejman Bardhi ka punuar në Uzinën e Lëndëve Plasëse, Mjekës, Elbasan me detyrë operator/punëtor në demontimin e lëndëve plasëse prej datës 01.02.2009. Me shkresën nr. 120 prot., datë 02.05.2014 të drejtorit të kësaj ndërmarrjeje shtetërore, kërkuesi është larguar nga detyra në repartin e demontimit të predhave 60m/m me motivacionin se “*përfundon puna në këtë linjë*”, duke iu ndërprerë marrëdhëniet financiare në datën 06.05.2014. Me pretendimin se zgjidhja e kontratës së punës ishte bërë në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi në datën 08.08.2014, me objekt detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblim në masën e pagës së 1 viti për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës; pagës së 2 muajve për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës; pagës së 3 muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit, dhe shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 2.5 muajve pagë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1307, datë 07.10.2014, ka vendosur moskompetencën e saj lëndore dhe dërgimin për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo e fundit, me vendimin nr. 408, datë 31.03.2015, ka vendosur dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Me vendimin nr. 00005, datë 29.01.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr.1307, datë 07.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

3. Me vendimin nr. 772 (82-2015-3660), datë 18.06.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, ka vendosur: “*Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës Elbasan të dëmshpërblejë paditësin Sulejman Bardhi, me 5 (pesë) muaj pagë për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin Sulejman Bardhi, me 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me 1 (një) pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit. Detyrimin e palës së paditur të shpërblejë paditësin me 2 (dy) paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë. Dëmshpërblimet e mësipërme llogariten mbi bazën e pagës mujore neto në fund të marrëdhënies së punës. Rrëzimin e padisë në pjesën tjetër.*”. Kundër këtij vendimi, në datën 18.06.2015, ka paraqitur ankim pala e

paditur, Uzina e Lëndëve Plasëse, Mjekës, Elbasan, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes. Kërkuesi ka paraqitur kundërankim në datën 13.07.2015, duke kërkuar mospranimin e ankimit të palës së paditur dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë për pjesën e pranuar të kërkesëpadisë. Gjithashtu, në datën 18.12.2015, kërkuesi ka paraqitur edhe ankim kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës në lidhje me pjesën e rrëzuar të kërkesëpadisë.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4463, datë 14.12.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin pjesërisht të vendimeve të gjykatave më të ulëta vetëm për sa i përket pjesës së rrëzuar të kërkesëpadisë në lidhje me masën e dëmshpërblimit dhe konkretisht duke kërkuar masën nga 5 në 12 paga për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënieve së punës, masën nga 1 në 3 muaj për mosrespektim të afatit të njoftimit, shpërblimin për vjetërsi në punë nga paga “neto prej 45.290 lekësh” në atë “bruto prej 52.300 lekësh”, në masën nga 2 në 2,5 muaj pagë dhe rillogaritjen e dëmshpërblimit të paguar.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4443, datë 07.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se ky i fundit e ka paraqitur ankimin ndaj vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë jashtë afatit ligjor të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile (KPC). Ndërsa në lidhje me rekursin e palës së paditur, ai kolegji ka vendosur mospranimin e tij, me argumentin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).

6. Në datën 14.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi objekt kundërshtimi i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë është shpallur në mungesë të kërkuesit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, sikurse rezulton edhe nga

procesverbali i seancës së datës 18.06.2015. Ky vendim i është komunikuar përfaqësuesit të kërkuarit në datën 09.12.2015, i cili ka ushtruar ankim në datën 18.12.2015 dhe pavarësisht faktit se ai ka paraqitur kundërankim në datën 13.07.2015, ankimi konsiderohet brenda afatit ligjor. Gjykata e Lartë duhej të kishte pranuar pretendimet e rekursit në drejtim të mosrespektimit të ligjit procedural nga gjykata e apelit, duke marrë në analizë ligjore datën e komunikimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndonëse rekursi përmbante shkaqe të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim çështjet ligjore të lidhura me zbatueshmërinë e ligjit procedural.

- 7.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi në vendimin e saj Gjykata Administrative e Apelit nuk ka paraqitur dhe nuk ka trajtuar me hollësi argumentet e kërkuarit për vlerësimin e afatit ligjor të paraqitjes së ankimit. Ajo gjykatë nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, duke mos shqyrtuar verifikimin e pranisë së palës gjatë dhënies së vendimit në gjykatën e shkallës së parë. Këto shkelje nuk janë korrigjuar as nga Gjykata e Lartë, megjithëse kërkuari kishte pretenduar se në gjykatën e apelit nuk ishin respektuar dispozitat ligjore, jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Në këtë mënyrë kërkuarit i është mohuar debati gjyqësor në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit.
- 7.3. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuari gjendet në kushte pabarazie me shtetasit e tjerë të cilëve u është pranuar shqyrtimi i rekursit kur ankimi ishte paraqitur brenda afatit ligjor. Në rastin e kërkuarit Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim as shkaqet e rekursit dhe as parashtrimet e paraqitura në datën 24.10.2023 pranë saj. Ajo gjykatë ka përdorur standard të dyfishtë për sa u përket subjekteve private dhe institucioneve të administratës publike në ato raste kur ankimi ishte ushtruar brenda afatit ligjor.
- 7.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë vetëm i ka cituar pretendimet e kërkuarit, pa i trajtuar ato hollësisht dhe pa kryer hetim mbi vendimin e gjykatës së apelit. Vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon tërësisht arsyetimi, pasi ajo nuk ka verifikuar praninë e kërkuarit ose përfaqësuesit të tij në datën e shpalljes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo datën e marrjes dijeni të atij vendimi. Për më tepër, ajo nuk ka cituar disa nga faktet e paraqitura në rekurs, nuk ka bërë interpretim ligjor të konfliktit në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe nuk u ka kthyer përgjigje

pretendimeve të kërkuarit në rekurs, por është mjaftuar me shprehje të formatit standard.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

9. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 07.11.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 14.02.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsytimit të vendimit si dhe parimit të barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës. Në pretendimet e tij në ankimin kushtetues individual, kërkuesi ka parashtruar se gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim ankimin e tij, me argumentin se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga KPC-ja. Në vijim, edhe Gjykata e Lartë nuk e ka korrigjuar këtë shkelje dhe nuk ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të paraqitur prej tij në këtë drejtim. Në këtë këndvështrim, nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit, bazuar në parimin *iura novit curia*, ato do të analizohen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit substancial, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial

13. Kërkuesi ka pretenduar se në kushtet kur vendimi i gjykatës së shkallës së parë është shpallur në mungesë të tij, ai ka ushtruar ankim në datën 18.12.2015, brenda afatit ligjor nga data e komunikimit të vendimit, pavarësisht faktit se ka paraqitur kundërankim në datën 13.07.2015. Ndonëse rekursi përmbante shkaqe të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim çështjet ligjore të lidhura me zbatueshmërinë e ligjit procedural. Kërkuesit i është mohuar debati gjyqësor në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka përdorur standard të dyfishtë për sa u përket subjekteve private dhe institucioneve të administratës publike në ato raste kur ankimi ishte ushtruar brenda afatit ligjor. Po kështu, Gjykata e Lartë vetëm i ka cituar pretendimet e kërkuesit, pa i trajtuar ato hollësisht dhe pa kryer hetim mbi vendimin e gjykatës së apelit dhe vendimit i mungon tërësisht arsytimi, pasi ajo nuk ka verifikuar praninë e kërkuesit ose përfaqësuesit të tij në datën e shpalljes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo datën e marrjes dijeni të atij vendimi. Për më tepër, ajo nuk ka cituar disa nga faktet e parashtruara në rekurs, nuk ka bërë interpretim ligjor të konfliktit në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuesit në rekurs, por është mjaftuar me shprehje të formatit standard.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial

dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa i përket respektimit të afateve ligjore për paraqitjen e ankimit, GJEDNJ-ja ka theksuar se e drejta e aksesit nënkupton marrjen e njoftimit të përshtatshëm të vendimeve gjyqësore, veçanërisht në rastet kur ankimi duhet të bëhet brenda një periudhe të caktuar kohore. E drejta e aksesit nuk është absolute, pasi ajo u nënshtrohet disa kufizimeve. Megjithatë këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla që të cenojnë thelbin e së drejtës së aksesit (*shih *Zavodnik kundër Sllovenisë, datë 21.05.2015, § 71 – 73**). E drejta e ankimit duhet të ushtrohet kur palët kanë marrë dijeni efektivisht për vendimin që ka përcaktuar për ta një detyrim ose ka cenuar një të drejtë të ligjshme (*shih *Ivanova and Ivashova Affairs kundër Rusisë, datë 26.01.2017, § 45**). Megjithatë kërkuarit duhet të tregojnë kujdesin e duhur për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë e parashikuara në ligj për të siguruar gjykimin e pretendimeve të tyre nga gjykatat (*shih *Kamenova kundër Bullgarisë, datë 12.07.2018, § 54**).

16. Kolegji vëren se referuar dispozitave të KPC-së në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit në gjykatën e apelit, në rastin në shqyrtim, pra në vitin 2015, afati për të bërë ankim në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, sipas nenit 443, ka qenë 15 ditë. Ndërsa neni 444 ka përcaktuar se afatet e përcaktuara në nenin 443 janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar dhe kur çështja është gjykuar në mungesë të njëjës palë, afati fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

17. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 772 (82-2015-3660), datë 18.06.2015, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë së kërkuarit, duke i akorduar atij dëmshpërblim në lidhje me zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës, për mosrespektimin e procedurës dhe të afatit të njoftimit, krahas shpërblimit për vjetërsi në punë. Në lidhje me masën e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës, kjo gjykatë ka arsyetuar se vlerësimi i kësaj mase është në diskrecion të saj brenda kritereve të parashikuara nga ligji, duke caktuar një shpërblim më të vogël nga ai i kërkuar nga kërkuari në objektin e padisë. Vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë është shpallur në mungesë të kërkuarit, prandaj në dispozitiv ajo është shprehur se kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve nga e

nesërmja e shpalljes, ndërsa për palën në mungesë ky afat fillon nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit.

18. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore rezulton se në datën 26.06.2015 ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë pala e paditur, Uzina e Lëndëve Plasëse, Mjekës, Elbasan. Ky ankim i është komunikuar kërkuarit me dëftesën e komunikimit të datës 03.07.2015. Në datën 13.07.2015 ai ka paraqitur kundërankim, duke kërkuar lënien në fuqi të atij vendimi vetëm për sa i përket pranimit të pjesshëm të kërkesëpadisë. Në kundërankim kërkuari ka pretenduar se vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë është i mbështetur në ligj dhe në prova për sa i përket konstatimit të faktit të zgjidhjes së menjëhershme pa shkak të justifikuar të kontratës së punës, mungesës së njoftimit dhe mosrespektimit të procedurës. Po kështu, qëndron edhe arsyetimi i asaj gjykate se marrëdhëniet e punës konsiderohen pa afat të caktuar sipas nenit 151 të Kodit të Punës. Sipas tij, gjykata administrative e shkallës së parë i ka ngarkuar barrën e provës punëdhënësit dhe në vijim ka aplikuar nenin 155 të Kodit të Punës, sipas të cilit në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata vendos një dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune. Në përfundim, kërkuari ka kërkuar që gjykata e apelit të mos pranojë pretendimet e paraqitura në ankim dhe të vendosë lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë.

19. Në vijim, sipas dëftesës së komunikimit rezulton se përfaqësuesi i kërkuarit ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë në datën 09.12.2015 dhe në datën 18.12.2015 ka paraqitur ankim me objekt ndryshimin e këtij vendimi për sa i përket pjesës së kërkesëpadisë lidhur me masën e dëmshpërblimit të caktuar nga ajo gjykatë dhe llogaritjen e tij sipas pagës bruto. Në datën 06.12.2016 kërkuari ka paraqitur parashtresë para Gjykatës Administrative të Apelit me përmbajtje të njëjtë me ankimin.

20. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4463, datë 14.12.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë. Në lidhje me ankimin e kërkuarit, ajo gjykatë, nisur nga fakti se ai ka paraqitur kundërankim në datën 13.07.2015 dhe ankim në datën 18.12.2015, ka vlerësuar se ankimi është paraqitur jashtë afateve ligjore të parashikuara në ligj dhe si i tillë nuk duhet të shqyrtohet. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuari, duke pretenduar, ndër të tjera, se ankimi është ushtruar brenda afatit 15-ditor nga komunikimi i vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, prandaj duhet të merrej në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit.

21. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin objekt kundërshtimi, ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuarit dhe palës së paditur. Për sa i përket kërkuarit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se rekursi i tij nuk mund të merret në shqyrtim, pasi kjo palë e ka paraqitur ankimin ndaj vendimit të dhënë nga gjykata administrative e shkallës së parë jashtë afatit ligjor të parashikuar në KPC e, për pasojë, ndaj këtij ankimi është disponuar mospranim nga Gjykata Administrative e Apelit. Në analizë të nenit 44 të ligjit nr. 49/2012 dhe 442 të KPC-së, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se e drejta e ankimit duhet kuptuar si një mundësi e çdo individit, për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Për rrjedhojë, ajo e ka konsideruar disponimin e Gjykatës Administrative të Apelit për mospranimin e ankimit, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit, si të drejtë dhe në përputhje me sa parashikohet në nenet 442, 450 të KPC-së dhe nenet 46 e vijues dhe 50 të ligjit nr. 49/2012 (*shih paragrafin 16 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

22. Në kontekst të rrethanave të mësipërme, Kolegji vlerëson se ndonëse formalisht sipas parashikimeve ligjore të mësipërme kërkuarit i ka lindur e drejta e ankimit në momentin kur vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë i është komunikuar përfaqësuesit të tij në datën 09.12.2015, sikurse u parashtrua më sipër, ai ka qenë në dijeni të këtij vendimi që në momentin kur i është komunikuar ankimi i palës së paditur. Edhe nga përmbajtja e kundërankimit vërehet se kërkuari ishte në dijeni të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe të argumenteve të parashtruar nga ajo. Nisur nga ky fakt, kërkuari duhej të kishte bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të paraqitur edhe shkaqet e ankimit të tij, gjë të cilën ka zgjedhur ta bëjë vetëm pas komunikimit formalisht nga gjykata të kopjes së vendimit. Pra, duke qenë në dijeni të përmbajtjes së vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, kërkuari mund dhe duhej të përdorte mjetin e njohur nga ligji për kundërshtimin e tij përmes ankimit, duke e paraqitur atë brenda afateve ligjore. Qëllimi i vënies në dispozicion të palëve i vendimit gjyqësor të arsyetuar është për t'u bërë të njohur atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë kështu mundësinë të paraqesin shkaqet e ankimit. Në këtë kuptim, ardhja në dijeni për vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe pranimi i këtij fakti nga kërkuari, ka diktuar për atë që të tregojë kujdesin e duhur për të respektuar afatet ligjore për ushtrimin e së drejtës së ankimit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se interpretimi i Gjykatës së Lartë në lidhje me afatin e paraqitjes nga kërkuari të ankimit kundër vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë nuk duket të jetë

haptazi i paarsyeshëm, ndaj pretendimi i tij për cenimin e së drejtës së aksesit substancial është i pabazuar.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.